

## PROCESVERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Peshkopi, në Bashkinë Dibër”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kanalizues, 44115100-0

**FONDI LIMIT:** Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **1,025,380,481.67** (një miliard e njëzet e pesë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtedhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Fondi limit në Euro 10,782,129.14. (Dhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet e nëntë pike katërmjedhjetë Euro) (Vlera në Euro është konvertuar sipas kursit zyrtar (95.47) të Bankës së Shqipërisë dt.14.05.2026 ora 20:22)

**KOHEZGJATJA E KONTRATËS/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PËR ZBATIMIN E SAJ : 18 (tetëmbëdhjetë) Muaj**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

#### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksa vetë konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të një pas njëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).*

**Shënim:***Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, I ndryshuar.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në*

*udhëzimin e ministrit përgjegjës për financa për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.*

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

**a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **512690240.84** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **2050760963.3** lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

**Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore për te vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes;
- b) Situacionin përfundimtar të objektit;
- c) Aktin e Kolaudimit të objektit;
- d) Formular Vlerësimi (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- e) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- Nëse kontrata është realizuar me subjekte private për te vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit të objektit

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për kontratat e realizuarasi Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:  
Kontratë bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht : **512690240.84** lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht **2050760963.3** lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse*

*pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.a – 1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

***Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.***

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.a – 1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarohet se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nenkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen sipas standartit.

AK ka kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”**

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të vlefshme të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

- **NP-1 C** Punime gërmimi në tokë
- **NP-2 D** Ndertime Civile dhe industriale
- **NP-4 E** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **NP-5 B** Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- **NP-7 F** Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje;
- **NP-9 A** Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- **NP-11 B** Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- **N.P-12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

**Për punimet speciale të ndërtimit :**

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-4 A** Punime rifiniture murature dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.
- **NS-6 A** Sinjalistika rrugore jo ndricuese
- **NS-8 A** Ndertime parafabrikat beton arme struktura metalike dhe druri
- **NS-14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- **NS-18 C** Punime Topogjeodezike

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr. 42, datë 16.01.2008 (i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

**-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

#### ***NP-1 C Punime gjërmimi në tokë***

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjërmimi në tokë konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjërmimit dhe sistemimit, kapitulli punimet ndërtimore në paragrafët përkatës, punime dhe gjërmimi në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore. Kategoria C i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### ***N.P - 2 D Ndërtime civile e industriale***

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti, ku sipas preventivit janë punimet e konstruksioni, realizimin e themeleve, mureve mbajtës dhe punime të tjera ndërtimore për ndërtimin e impiantit. Kategoria D i referohet vlerës së punimeve në preventiv të rikonstruksionit sipas përcaktimeve në preventivin e projektit .

***N.P - 4 E Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.***

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaj, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.*

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti, ku sipas preventivit janë punimet për asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve ku do realizohet ndërhyrja për hapjen e rrjetit të kanalizimeve. Kategoria E i referohet vlerës së punimeve në preventiv të rikonstruksionit sipas përcaktimeve në preventivin e projektit .

#### ***N.P - 5 B Punime nëntokësore, ura e vepra arti***

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti, ku sipas preventivit janë parashikuar punime për shpime , kalime nëntokësore . Kategoria B i referohet vlerës së punimeve në preventiv të rikonstruksionit sipas përcaktimeve në preventivin e projektit .

#### ***N.P - 7 F Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje***

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punimet hidroteknike. Dokumentacioni teknik dhe preventivi i hartuar nga projektuesi parashikon punime të shkarkimit e ujërave të zeza. Kategoria F i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### ***N.P - 9 A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime***

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e*

*lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punimet forcimit të shpatave dhe argjinaturave sipas specifikimeve teknike. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### ***N.P - 11 B Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike***

*Të tilla punime sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 “Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punimet elektrike. Dokumentacioni teknik dhe preventivi i hartuar nga projektuesi parashikon ndertimin e kabinave elektrike dhe linjat shpërndarëse elektrike të jashtme . Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### ***N.P - 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit***

*Të tilla punime sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punimet të ndryshme si hapja e kanaleve për rrjetin e kanalizimeve , ndertimi impiantit që ndikojnë në mjedis. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### ***N.S - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve***

*Të tilla punime sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 Konsiderohen çmontimin e impianteve industriale dhe prishjen komplet të ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Vendosja e këtij kriteri lidhet drejtëpërdrejtë me punimet e parashikuara në ndërhyrjen objekt kontrate të cilat janë prishje shtresash betoni , mur tulle , kollona etj. Këto punime përshkruhen në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

***N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.***

Me punime të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punime murature, rifiniture, boje, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash për punime të ndryshme izolimi. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

***N.S - 6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese***

Me punime të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë vendosje e sinjalistikave rrugore gjate realizimit të punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

***N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri***

Me punime të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *Konsiderohen prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.*

*Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punime të konstruksioneve metalike përgodinen e stacionit fryresave , impiantit , ndertimin e shkalleve etj. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

***N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.***

Me punime të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punime për rrjetet elektrike dhe elektronike, të tilla rrjeti i ndricimit, ndricimit emergjent, planet e linjave shperndarese,

telefoni - fiber optike, projekti CCTV dhe skema e panelit te ndricimit etj Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

### **N.S - 18 C Punime topogjeodezike**

Me punime të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Vendosja si kriter teknik i kësaj pike license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikojnë punime të realizimi e piketimit e sakte te gjurmes rrjetit kanalizimeve , germim kuotave dhe pjerresive ,matjen e volumeve. Duke qënë se kemi ndërtim te impiantit kërkohet që gjatë gjithë procesit të ndërtimit të objektit nevojitet piketimin e strukturës hap pas hapi të cdo elementi përbërës, si në plan dhe në lartësi.

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë;
- c) Libreze pune.

**Shënim:** Ky kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet ne nenin 77, pika 4 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” te VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune, sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se:

*“Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

#### **2.3.4 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për këto punime:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Elektronik**

*Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:*

- Stafit teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** AK argumenton se kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Punimet apo veprimtarite konkrete për të cilat kërkohej ekspertiza e tyre profesionale janë:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore sipas parashikimeve në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv ndërtimit impiantit.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshin kuota dhe piketime lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve mjedisore për mbrojtjen e mjedisit lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Elektronik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektronike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.

**2.3.5** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf mbështetes jo domosdoshmerisht te përfshire ne licensen e shoqerise për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periodhen **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Infrastruktura e transportit.
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist.
- 1 (një) Inxhinier i specializuar per testimin e performances se produkteve te ndertimit.

**Shënim:***Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

*Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën*

*Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.*

- Inxhinier Ndërtimi profili Infrastruktura e transportit është përgjegjës për zbatimin dhe e punimeve që lidhen me infrastrukturën rrugore, përfshirë ndërtimin, rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugëve. Ky specialist siguron që punimet të realizohen në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë rrugore, cilësinë e shtresave rrugore dhe funksionalitetin e tyre.
- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist është përgjegjës për analizën dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së strukturave inxhinierike që lidhen me objektin e ndërtimit te impiantit. Ky specialist siguron që elementët strukturorë, si muret mbajtëse pusetat, elementët prej betoni dhe struktura të tjera ndihmëse, të projektohen dhe zbatohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë.
- Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialelesh është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t’u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj

specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

a) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jenë të pajisur me çertifikatën e Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, e lëshuar nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e **3 (tre) muajt e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

b) - 1 (një) person, pjesë e stafit të shoqërisë, të pajisur me çertifikatën si specialist **Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e **3 (tre) muajt e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

c) Minimumi 1 (një) punonjës Auditues/**Inspektues i Sigurisë Rrugore**, i certifikuar sipas VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore" dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore". (Do të pranohet dhe me kontratë shërbimi)

**Shënim:** Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

-“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete në kantier për trajnimin e punonjesve të kantierit për minimizimin e aksidenteve në punë.

- “Specialist Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin rekomandohet të jetë në kantier për marrjen e masave të menjehershme në rastet e zjarreve në kantier.

-“Inspektues i Sigurisë Rrugore” kontrollon dhe verifikon zbatimin e masave të sigurisë gjatë fazës së punimeve, duke përfshirë sinjalistikën e përkohshme, vendosjen e barrierave mbrojtëse, identifikon dhe vlerëson rreziqet e mundshme për përdoruesit e rrugës si pasojë e hapjes së kanaleve, prishjes së shtresave rrugore dhe ndërhyrjeve të tjera ndërtimore etj.

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **150 (njqind e pesëdhjete) punonjës** punonjës për periudhën **3 (tre) muajt e fundit** nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe

Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës përkatëse në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 150 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në kater elementet e struktures së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min 150 punonjës.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listëpagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

- |                           |                           |
|---------------------------|---------------------------|
| - 3 (tre) Teknik Ndërtimi | Diplomë të shkollës mesme |
| - 1 (një) Teknik Topograf | Diplomë të shkollës mesme |
| - 1 (një) Teknik Mekanik  | Diplome të shkollës mesme |

- 1 (nje) Teknik Elektrik Diplome te shkolles mesme
- 1 (nje) Teknik Saldator Diplome te shkolles mesme
- 1 (nje) Teknik Hidraulik Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 2 (një) Hekurkthyes Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- 4 (kater) Karpentierë Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- 2 (dy) Hidroizolues Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- 2 (dy) Bojaxhi Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 2 (dy) Murator Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 2 (dy) Suvatues Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 2 (dy) Pllakashtrues Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 2 (dy) Betonues Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 3 (tre) Montator (konstrukionemetalike) Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 2 (dy) Saldator Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- 2 (dy)Elektracist Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- 1 (nje) Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 3 (tre) Specialist per ndërtim Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 4 (kater) Hidraulik Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 5 (pese) Punëtores per punime ne rruge dhe asfaltim. Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale

Krahas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

nr .	emërmbiemëri punonjësit	profesi oni	institucioni public/privatlëshuesicertifik atës/diplomës	nr. icertifikatës/di plomës	nr nipt (në rast se lëshuesi është instituc ion privat)
1.					
2.					
et j.					

**Shënim:** Disponimi I stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në dst, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secalin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: për specialistët e sipër cituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi ose cdo document tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/osekualifikimin e tyre sipas profesionit, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë. -Operatori ekonomik për Saldatoret e deklaruar, te jene te pajisur dhe certifikuar me: EN ISO 9606-1:135 PALTE FW FM1 S t12 PF ml, ss,mb per testimin e saldimit. Per permbushjen e ketij

*kriteri do te pranohen vetem certifikatat e leshuara nga institucionet e akredituara perkatëse ose ekuivalentin e tyre dhe kontratat e punës.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional.Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te jane bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- 7 (shtate) manovrator Eskavatoristë
- 3 (tre) manovrator Automakinistë
- 2 (dy) manovrator Buldozeristë
- 10 (dhjetë) Shoferë të makinerive të rënda

Ofertuesi për stafin e mësipërm duhet të paraqesë:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- d) Punetoret mesipermtefigurojnenelistepagesapër periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

***Në rastin kur punonjësit Automakinist, Eskavatoristë, Shofer ose Buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).***

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit te ofertave , duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) Neni 39, pika 6, gërma “c”.

- Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar **1 (një) Punonjes Manovrator/Shofer** me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve të gërmimit me eskavator , transportit të materialeve etj

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
4	Rimorkiator per transport mjtesh te renda min 20 ton + koke terheqese	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 3.5 – 5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Auto vinç kapacitet mbajtes min 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	2 copë	Në pronësi ose me qera
8	Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti	2 copë	Në pronësi ose me qera
9	Rrulpërbankina	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Fadrome (MT) me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
11	Eskavator me zinxhir + çekiç (matrapik)	2 copë	Në pronësi ose me qera
12	Eskavator me zinxhir mbi 30 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
13	Eskavator (MT) me goma 0.25m3	2 copë	Në pronësi ose me qera
14	Minieskavator (MT) me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Minifadrome (MT) me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
16	Minifadrome (MT) me targa me pirun teleskopik	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Minidumper pesha mbajtese 2 - 5 ton (MT) me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
18	Dumper me kapacitet mbi 25 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
19	Trancher për hapje kanali 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
20	Autofshese me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
21	Autobot uji per furnizim me uje te kamionit teknologjik me kapacitet mbajtes min 7500 litra.	1 copë	Në pronësi ose me qera
22	Makineri teknologjike (autobot per transport te ujerave te zeza dhe e paisur me pompe me presion per larjen e	1 copë	Në pronësi ose me qera

	pusetave) jo me shum se 1m3.		
23	Grejder me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
24	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
25	Miniasfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
26	Autobitumatriçe	3 copë	Në pronësi ose me qera
27	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
28	Autobetonierë	3 copë	Në pronësi ose me qera
29	Autopompë betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
30	Makineri (spërkatës) për vijezim rruge me bojë bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qera
31	AutoBetonierë kantieri MT (me targa) 2 - 3.5 m <sup>3</sup>	1 copë	Në pronësi ose me qera
32	Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase	500 m <sup>2</sup>	Në pronësi ose me qera
33	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	2 cope	Në pronësi ose me qera
34	Pajisje për hekurkthyes (tranxhë / elektrobango)	2 copë	Në pronësi ose me qera
35	Makineripërshpim horizontal përtëzëvendësuar tubine kuzistues përkalimin e tubacioneve	1 copë	Në pronësi ose me qera
36	Makineri me lazer përgërmim kanal inëntokësormikrotunel me diametër jo më të vogël se 140 mm	1 copë	Në pronësi ose me qera
37	Autobot pajisur me pompe presioni dhe pompe vakumi vetëshkarkuese e pajisur edhe me depozite per transport te ujit te paster dhe mbetjeve te tjera per testimin e rrjetit	1 copë	Në pronësi ose me qera
38	Automjet teknologjik per pastrim tubi, i pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo me pak se 150 bar, prurje jo me pak se 300 litra/minute dhe sonda me gjatesi jo me pak se 70m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve me kapacitet jo me te vogel se 1400 m3/ore, e pajisur me bot per largimin e mbeturinave me kapacitet bartes jo me pak se 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
39	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
40	Vibrator betoni	4 copë	Në pronësi ose me qera
41	Tokmak për ngjeshje dheu	2 copë	Në pronësi ose me qera
42	Gjenerator kantieri	3 copë	Në pronësi ose me qera
43	GPS/Total Station	2 copë	Në pronësi ose me qera
44	Nivelues/Helikopter betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
45	Pajisje per kapjen dhe montimin e bordurave	1 copë	Në pronësi ose me qera
46	Motosharre per prerje bimesh	5 cope	Në pronësi ose me qera
47	Gazogjen	2 copë	Në pronësi ose me qera
48	Prerese asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera
49	Vinç eskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
50	Vinç kulle 0.5 – 1 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
50	Fabrike asfalti	1 copë	Në pronësi / me qera/ kontrate furnizimi

51	Fabrike betoni	1 copë	Në pronësi / me qera/ kontrate furnizimi
52	Nyje inerte	1 copë	Në pronësi / me qera/ kontrate furnizimi

Operatori ekonomik ne vijim duhet te dispoinoje gjithashtu mjetet dhe paisjet mbrojtëse në punë si me poshte:

- Kokore mbrojtëse 150 copë
- Jelekë 150 copë
- Fikse Zjarri 10 copë
- Tabela Sigurimi Teknik 15 copë
- Kuti Ndhmë e shpejtë 10 copë

**Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si mëposhtë:**

*a)Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certificate për transport mallrash.*

*b)Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certificate për transport mallrash.*

*c)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qiratë tij.*

*d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secalin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*e)Për autobitumatriçe të paraqitet certificate për transport mallrash të rrezikshme.*

*f) Per impiant Inerte, Asfalti dhe Asfalto-beton per te cilat duhet te paraqese dhe lejen mjedisore te vlefshme per zhvillimin e ketyre aktiviteteve sipas kodeve perkatese (te tijen nese i ka ne pronesi ose te prodhuesit nese i ka me akt marveshje).*

*g)Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklarara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.*

*h)Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetës e për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullavetë Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerve, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetë të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.11 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga *prodhuesit* ose nga *distributorët e autorizuar nga prodhuesit*, për tregtimin e artikujve/pajisjeve që do të përdoren në funksion të realizimit të zërave përkatës të preventivit të punimeve (sipas listës së përcaktuar në pikën 2.3.12, të DT). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributor të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.12 Operatorët ekonomikë duhet që për të gjitha pajisjet e listuar në tabelën e mëposhtme, të deklarojnë/paraqesin : **specifikimet teknike (referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes se katalogëve për çdo artikull/pajisje etj.) kompaninë prodhuese së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese**, me qëllim verifikimin e origjinës së artikujve dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Me anë të kësaj skede teknike ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se artikujt/pajisjet që do të furnizojë do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me ato të deklaruara në ofertë dhe do të përdoren në funksion të realizimit të zërave përkatës të preventivit të punimeve.

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes se katalogëve për çdo artikull/pajisje etj.	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	F.V.Pompë zhytëse grirëse per kanalizime Q=50 l/sek, H=8m, N=8kW shoqëruar me zinxhir		
2	F.V.Perzieres per ujerat e ndotura 4kW sebashku me aksesori instalimi ne rezervuarin e rregullimit te prurjes		
3	F.V.Pompa zhytëse centrifugale per transport ujera te ndotura Q=37 l/sek, H=8m, pajisur me zinxhir per nxjerrje pompe per mirembajtje		
4	F.V.Vidë presë per dehidratim llumi		

	Q=8.67 m <sup>3</sup> /orë, 260 kg-DS/orë, komplet me gjithë aksesore		
5	Skid pompash dozimi me membrane Q <sub>max</sub> =14.85 l/h, U=220v me kontroll sinjali analog 4÷20 mA, me rregullim automatik 0÷100% me tre kundralvula me rregullim presioni me mat PVC-U me lidhje 3/4" me rang rregullimi 0.5÷10 bar, me nje pulmon me mat. PVC/C8M/EPDM me P <sub>max</sub> =8 bar me lidhje 3/4" me Q=0.8 l dh		
6	.Fryresajrivolumetrik me inverter Q=5150 m <sup>3</sup> /orë, Dp=300mbar, Fuqi teorike N=65.11kW (furnizim me ajer per rezervuarnitrifikim), pajisur ne thithje me silenciator, valvul, filter		

- Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj tablele është kusht skualifikues.

**Argumentimi** : Kërkesa e mësipërme pika 2.3.11 dhe pika 2.3.12 është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe ,në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventiv. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rëndësia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që ne kete faze krijon nje lehtësi per Autoritetin Kontraktor pasi ne kete menyre siguron cilesine, specifikimet teknike te ketyre pajisjeve e cila eshte lehtesisht e kontrollueshme gjate fazes se zbatimit ne reference me dokumentat e paraqitura qe gjate kualifikimit. Nepermjet dorezimit te këtij dokumentacioni qe ne fazen e vleresimit asnje OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimet qe gjate zbatimit te furnizoje te njejtin mall te certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në

këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave te projektit. Plotësimi i kërkeses me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

**2.3.13** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

\* **ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilësisë )ose ekuivalente**

\* **ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit Mjedisor ) ose ekuivalente**

\* **ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistemi Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë) ose ekuivalente**

\* **EN-ISO 3834-2:2021“Sisteme të menaxhimit të cilësisë në saldim”, ose ekuivalente**

**Shënim:** *Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

*Certifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse certifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.*

*Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomik, sipas natyrës së punëve që marrin për sipër.*

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.13 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-2018/45001-2023** është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**EN-ISO 3834-2:2021/ ekuivalente** është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr pjesë punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilesise se ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.13, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

**2.3.14** Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mjetëve të Ngurta.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.*

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B*

*është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”.*

Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.*

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

**2.3.15** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Grafikon e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.16** Operatori Ekonomik për materialet e meposhtme duhet të paraqesë:

- Materialet tuba të brinjezuar HDPE SN8 Ø 160 mm – 800mm çertifikate me ISO 9001, si dhe leje mjedisore Kodi III.1.B “ për riciklim materiali plastik”.
- Bordura betoni 15x35 cm të paraqitet kataloget përkatëse dhe ISO 9001/ekuivalente për cilësinë
- Hekur të paraqitet kataloget përkatëse dhe ISO 9001/ekuivalente për cilësinë.
- Tuba korregato duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. Kërkesa e këtij dokumenti që në këtë fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi në këtë mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike

te ketyre pajisjeve e cila eshte lehtesisht e kontrollueshe gjate fazes se zbatimit ne reference me dokumentat e paraqitura qe gjate kualifikimit.

Kjo kerkese eshte kerkuar qe t'i siguroje Autoritetit Kontraktor qe operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit per zbatimin ne kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

OE duhet të provojë se ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Plotesimi i kerkeses me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

**2.3.17** Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, dhe asfaltit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSHEN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019, SSH EN 12697- 5:2018, SSH EN 1426 :2015 ose ekuivalente.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për një laborator testimi të betonit dhe asfaltit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 2 dhe 4.

**Argumentim: Specifikimet teknike:** janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi, duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/a dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

***Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.***

***Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.***

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

